

Anketa e Kostos së Punës

Metadata Referenciale në format ESS Standard for Quality Reports
Structure (ESQRS)

INSTAT

Metadata referenciale

1. Kontaktet.....	2
2. Paraqitja statistikore.....	2
3. Përpunimi statistikor.....	5
4. Menaxhimi i cilësisë.....	5
5. Rëndësia.....	6
6. Saktësia dhe besueshmëria.....	6
7. Afatet kohore dhe përpikmëria.....	9
8. Koherenca dhe krahasueshmëria.....	10
9. Aksesit në të dhëna dhe qartësia.....	11
10. Kostoja dhe ngarkesa.....	12
11. Konfidencialiteti.....	12
12. Komentet.....	13
Aneks.....	13

1. Kontaktet	
1.1. Institucioni i kontaktit	Instituti i Statistikave, INSTAT
1.2. Njësia e kontaktit	Sektori i Statistikave të Tregut të Punës dhe Pagave, Drejtoria e Statistikave të Sektorit Real
1.3. Personi i kontaktit	Julinda Haçkaj
1.4. Funkzioni i personit të kontaktit	Specialist, Sektori i Statistikave të Tregut të Punës dhe Pagave
1.5. Adresa postare	Rr. Vilazën Huta, Nd.35, H.1 Njësia Administrative Nr.2, 1017 Tiranë
1.6. Adresa elektronike (e-mail)	jhackaj@instat.gov.al
1.7. Numri i telefonit	+(355) 4 2222411 / +(355) 4 2233356
1.8. Numri i faksit	+(355) 4 2228300
2. Paraqitja statistikore	
2.1. Përshkrimi i të dhënave	<p>Qëllimi i Anketës së Kostos së Punës është të sigurojë të dhëna të sakta, të hollësishme dhe të harmonizuara për kostot e punës së ndërmarrjeve për organizmat kombëtare, organizatat e punëdhënësve dhe punonjësve, universitetet dhe institutet kërkimore. Anketa lidhet me kostot e punës të dhëna nga punëdhënësi dhe kërkon informacion për pagat e punonjësve, punën jashtë orarit, shpërblimet, kompensimet, përfitimet e vogla dhe kostot e tjera të punës të bëra nga punëdhënësi gjatë gjithë vitit të referencës.</p> <p>Anketa e Kostosë Punës kryhet në përputhje me Rregulloret Evropiane: EC 530/1999 dhe EC 1737/2005.</p>
2.2. Sistemi i klasifikimit	<p>Të dhënat për AKP janë të disponueshme sipas aktivitetit ekonomik bazuar në Nomenklaturën e Veprimtarive Ekonomike (NVE).</p> <p>Nga viti referues 2016 e tutje është miratuar klasifikimi i NVE Rev. 2.</p>
2.3. Mbulimi i sektorit	Popullsia e synuar e këtij anketimi janë ndërmarrjet që punësojnë

	<p>10 ose më shumë persona dhe operojnë në Seksionet B deri në S, përjashtuar Seksionin O të NVE Rev.2. Kjo nënkupton që relativisht të gjitha llojet e aktiviteteve ekonomike janë përfshirë në grupin e synuar, përveç aktiviteteve të bujqësisë dhe peshkimit dhe administratës publike - ndërmarrjeve të lidhura.</p>
<p>2.4. Koncepte statistikore dhe përkufizime</p>	<p>Kostot e punës i referohen shpenzimeve totale që kryejnë punëdhënësit për stafin e punësuar, Ato përfshijnë kompensimin për të punësuarit, i cili përbëhet kryesisht nga pagat bruto në kesh ose në natyrë dhe kontributet e sigurimeve shoqërore që paguan punëdhënësi, kostot e trajnimit profesional, shpenzime të tjera si kostot e rekrutimit dhe shpenzimet për veshje pune, taksat e punësimit nga të cilat zbriten subvencionet e marra,</p> <p>Kostot mesatare orare të punës janë kostot vjetore të punës pjesëtuar me numrin e orëve punuar gjatë vitit të referencës,</p> <p>Kostot e punës në muaj për të punësuar kundrejt pagesës janë kostot vjetore të punës të pjesëtuar me 12 dhe me numrin mesatar të të punësuarve kundrejt pagesës gjatë vitit të referencës (konvertuar në ekuivalente të kohës së plotë),</p> <p>Të Punësuarit me Pagë janë të gjithë personat që punojnë direkt me ndërmarrjen dhe marrin pagesë nga punëdhënësi</p> <p>Të punësuar me pagë me kohë të plotë janë ata persona orët e zakonshme të punës së të cilëve janë të njëjta me orët rënë dakord kolektivisht ose me orët e zakonshme të punuara në ndërmarrje, edhe nëse kontrata është për më pak se një vit,</p> <p>Të punësuar me pagë me kohë të pjesshme janë personat që përgjithësisht punojnë më pak orë se të punësuarit me pagë me kohë të plotë të të njëjtës ndërmarrje,</p> <p>Praktikantët janë të punësuarit me pagë që akoma nuk marrin pjesë tërësisht në procesin e prodhimit dhe që punojnë ose nën një kontratë stazhi ose në një situatë në të cilën trajnimi profesional predominon kundrejt produktivitetit,</p> <p>Numri mesatar i orëve në javë të punuara zakonisht -janë orët e punuara zakonisht ose orët e kontraktuara për një të punësuar me pagë të kategorive që vijojnë: një i punësuar me pagë me kohë të plotë, një i punësuar me pagë me kohë të pjesshme, një praktikant</p> <p>Pagat për të punësuarit me pagë me kohë të plotë dhe të pjesshme përfshijnë shpërblimet, pagesën për copë dhe punën me turne, shtesat/dietat, honorarët, bakshishet, komisionet dhe pagesat në natyrë,</p> <p>Pagesat direkte, shpërblimet dhe shtesat përfshijnë vlerat e çdo kontributi social, taksave mbi të ardhurat, etj, të pagueshme nga i punësuarit me pagë edhe nëse ato faktikisht mbahen nga punëdhënësi dhe paguhen direkt në skemat e sigurimeve shoqërore, tatim-taksat etj, në emër të të punësuarit me pagë,</p> <p>Pagesat për ditët kur nuk është punuar (përfshihet vetëm pjesa e</p>

	<p>mbuluar nga punëdhënësi) Kompensimi paguhet për lejen e dhënë ligjore, të kontraktuar ose vullnetare dhe për festat publike apo ditë të tjera të paguara kur nuk punohet,</p> <p>Pagesa në natyrë ose Përfitimet shtesë, janë pagat dhe rrogat të cilat nuk janë transaksione kesh, ata janë mallrat, shërbimet, apo përfitimet të tjera të cilat sigurohen falas ose me çmime të reduktuara nga ana e punëdhënësit për të punësuarit me pagë,</p> <p>Kontributet e punëdhënësit për sigurimet shoqërore (përfshirë praktikantët) janë kontributet shoqërore të dhëna nga punëdhënësit në mënyrë që të sigurojnë për punonjësit e tyre (me kohë të plotë dhe të pjesshme) të drejtën për përfitimet sociale,</p> <p>Kostot e trajnimit profesional të paguara nga punëdhënësi janë shpenzimet për shërbimet dhe lehtësirat për trajnimet profesionale,</p> <p>Taksat e punësimit (Jo taksat mbi të ardhurat) mbulojnë të gjitha taksat në bazë të faturës së pagave dhe rrogave, ose në punësim, Këto taksa janë konsideruar si kosto pune, Gjithashtu mbulon taksat ndëshkimore të paguara nga punëdhënësit për punësimin e shumë pak personave me aftësi të kufizuar, si dhe taksa të tjera të ngjashme,</p> <p>Subvencionet e marra nga punëdhënësi janë të gjitha shumat e marra në formën e subvencioneve të një natyre të përgjithshme nga ana e punëdhënësit me qëllim që të kthehen një pjesë ose të gjitha si kosto e shpërblimit të drejtpërdrejtë të punonjësve, por nuk ka për qëllim për të mbuluar shpenzimet për sigurimet shoqërore ose trajnimet profesionale,</p> <p>Periudha e referencës - Të dhënat e mbledhura nga anketa e kostove të punës i referohen vitit 2020 i cili është dhe viti referencë.</p>
2.5. Njësia statistikore	Njësia statistikore është ndërmarrja.
2.6. Popullata statistikore	AKP zbatohet për të gjitha aktivitetet në seksionet B deri S (duke përfshirë seksionin O) të NVE Rev.2 dhe përfaqëson të gjitha njësitë statistikore që kanë 10 të punësuar e më shumë.
2.7. Zona e referencës	Të dhënat e Anketës së Kostos së Punës janë përfaqësuese në nivel vendi (NUTS 2).
2.8. Mbulimi në kohë	Të dhënat e AKP janë të disponueshme për vitin 2012, 2016 dhe 2020.
2.9. Periudha bazë	Nuk aplikohet.

3. Përpunimi statistikor	
3.1. Burimi i të dhënave	Kampionimi për Anketën e Kostos së Punës u bazua në Regjistrin Statistikor të Ndërmarrjeve 2020. Njësitë statistikore janë ndërmarrje me së paku 10 punonjës për NVE Rev 2, seksionet B deri S (duke pëjashtuar seksionin O). 3256 ndërmarrje u zgjodhën në kampion.
3.2. Shpeshtësia e grumbullimit të të dhënave	Çdo 4 vjet.
3.3. Grumbullimi i të dhënave	Të dhënat u mblodhën nëpërmjet pyetësorëve letër. Në disa raste, pyetësorë elektronik u janë dërguar kompanive që i kanë kërkuar me e-mail.
3.4. Vlefshmëria e të dhënave	Për të minimizuar gabimet e përpunimit, çdo pyetësor i ardhur u kontrollua nga statisticienët e trajnuar duke u bazuar në një listë rregullash logjike. Kontrollë të tjera u kryen në fazën e analizës, ku të dhënat u krahasuan me të dhënat administrative.
3.5. Përpilimi i të dhënave	Në rastet e mungesës së informacionit u përdoren të dhënat administrative duke u bazuar në aktivitetin ekonomik të ndërmarrjes dhe numrin e të punësuarve nga të dhënat administrative.
3.6. Rregullimi	Nuk aplikohet.
4. Menaxhimi i cilësisë	
4.1. Sigurimi i cilësisë	INSTAT është i angazhuar të sigurojë cilësinë më të lartë në lidhje me përpilimin e statistikave zyrtare. Në përputhje me "Ligjin për Statistikat Zyrtare", Nr.17 / 2018, datë 17.04.2018, INSTAT përdor metoda dhe procese statistikore në përputhje me parimet dhe standardet shkencore të njohura ndërkombëtarisht dhe kryen analiza të vazhdueshme të statistikave me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe sigurimin e statistikave sa më të përditësuar. Në kryerjen e detyrave të tij, INSTAT ndjek parimet e përgjithshme të menaxhimit të cilësisë në përputhje me Kodin e Praktikës të Statistikave Evropiane. INSTAT deklaron se merr parasysh parimet e mëposhtme: paanshmërinë, cilësinë e proceseve dhe produkteve, orientimin e përdoruesit, orientimin e punonjësve, efektivitetin e proceseve statistikore, zvogëlimin e ngarkesës së punës për të përgjigjurit.
4.2. Vlerësimi i cilësisë	Sipas Rregullores së Këshillit Evropian nr. 698/2006 të datës 5 maj 2006, për zbatimin e Rregullores së Këshillit (EC) Nr. 530/1999,

	lidhur me vlerësimin e cilësisë së statistikave strukturore mbi kostot e punës dhe fitimet, secili shtet anëtar duhet të përgatisë një raport për cilësisë e AKP-së 24 muaj pas periudhës referuese.
5. Rëndësia	
5.1. Nevojat e përdoruesit	<p>Përdoruesit e AKP klasifikohen si përdorues të brendshëm dhe të jashtëm.</p> <p>Përdoruesit e jashtëm janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Institucionet kombëtare: ministritë, agjencitë, këshillat, organet e tjera qeveritare dhe institucionet publike, • Organizatat ndërkombëtare: Eurostat, ILO etj, • Partnerët socialë: sindikatat, organizatat e punëdhënësve, • Organizata private, ndërmarrje, media, • Studiues dhe studentë, <p>Përdoruesit e Brendshëm janë sektorë të tjerë brenda INSTAT që përdorin rezultatet e AKP si input për punën e tyre si:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Drejtoria e Statistikave Ekonomike • Drejtoria e Llogarive Kombëtare
5.2. Kënaqësia e përdoruesit	<p>Gjatë vitit 2021, INSTAT ka kryer vrojtimin për matjen e kënaqësisë së përdoruesve. Rezultatet e vrojtimit tregojnë se cilësia e përgjithshme e temës “Anketa e Kostos së Punës” është vlerësuar me 3,53 (70.6%) nga një shkallë prej 1 (shumë e dobët) deri në 5 (shumë e mirë).</p> <p>INSTAT organizon çdo vit Anketën e Kënaqësisë së Përdoruesve.</p>
5.3. Plotshmëria	<p>Në AKP janë mbuluar të gjitha variablat e detyrueshëm sipas Rregullores së Komisionit (KE) Nr 1737/2005.</p> <p>Sa i përket madhësisë së ndërmarrjes dhe mbulimit sipas aktivitetit ekonomik, ndërmarrjet e vogla (me më pak se 10 punonjës) si dhe seksioni O i NVE.Rev.2 përjashtohen nga anketa.</p>
5.3.1. Plotshmëria e të dhënave - shkalla e plotshmërisë së të dhënave	<p>Të gjithë variablat e detyrueshëm të kërkuar në Rregulloren e Komisionit 1737/2005 u përfshinë në Anketën e Kostos së Punës 2020. Pra, shkalla e plotshmërisë së të dhënave për AKP 2020 është 100%, e shprehur si raport i numrit të variablave të mbledhur nga INSTAT dhe numrit të variablave të kërkuar nga EUROSTAT.</p>
6. Saktësia dhe besueshmëria	
6.1. Saktësia e përgjithshme	<p>Për sa i përket kërkesave të saktësisë, është rregullorja e Komisionit European për AKP e cila përcakton rregullat e dizenjimit të kampionit përkatësisht, madhësisë efektive të kampionit që duhet të arrihet dhe përfaqësimit të kampionit.</p>

	Në përgjithësi, të dhënat kontrollohen me vitet e mëparshme për të identifikuar ndonjë ndryshim të rëndësishëm në to. Konsistenca e brendshme e të dhënave kontrollohet para se të finalizohet. Kontrollohen lidhjet mes variablave dhe konfirmohet koherenca midis serive të ndryshme të të dhënave.
6.2. Gabim i kampionimit	Gabimet standarde të treguesve kryesorë përdoren zakonisht si një masë e besueshmërisë së të dhënave të mbledhura përmes anketës.
6.2.1. Gabimet në kampionim - indikatorët	Shiko tabelat në Aneks.
6.3. Gabim jo i kampionimit	<p>Gabimet jo të kampionimit në thelb janë të 4 llojeve:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Gabimet e mbulimit: gabimet për shkak të divergjencave ekzistuese midis popullatës së synuar dhe kornizës bazë të kampionimit. 2. Gabimet e matjes: gabimet që ndodhin në kohën e mbledhjes së të dhënave. Ekzistojnë një numër burimesh për këto gabime siç janë instrumenti i anketës, sistemi i informacionit, intervistuesi dhe mënyra e mbledhjes së të dhënave. 3. Gabimet e përpunimit: gabimet në proceset pas mbledhjes së të dhënave si futja e të dhënave në program, editimi dhe peshimi. 4. Gabimet e mospërgjigjes: gabime për shkak të një përpjekje të pasuksesshme për të marrë informacionin e dëshiruar nga një njësi e pranueshme.
6.3.1. Gabimi në mbulim	<p>Gabimi i mbulimit përfshin si mbi-mbulim, nën-mbulimin dhe klasifikimi i gabuar.</p> <ul style="list-style-type: none"> • mbi-mbulim: ka të bëjë ose me njësi të klasifikuara gabimisht që janë në të vërtetë jashtë fushës së veprimit, ose njësi që nuk ekzistojnë në praktikë; • Nën-mbulimi: i referohet njësive që nuk përfshihen në kornizën e kampionimit; • Klasifikimi i gabuar: i referohet klasifikimit të pasaktë të njësive që i përkasin popullatës së synuar. <p>Sa i përket numrit të punonjësve është e rëndësishme të theksohet se në këtë numër përfshihen jo vetëm punonjësit me kohë të plotë, me kohë të pjesëshme dhe praktikantët por edhe pronarët dhe punëtorë të familjes, pra klasat e madhësisë së ndërmarrjeve janë të ndryshme në koncept nga ato të AKP.</p>
6.3.1.1. Shkalla e mbi-mbulimit	Shkalla e mbi mbulimit në Anketën e Kostos së Punës është 1.5%.
6.3.1.2. Pjesa e njësive që mbulohej edhe nga anketa edhe nga burimi administrativ	Nuk aplikohet.

6.3.2. Gabimi në matje	<p>Burimet e zakonshme të gabimeve të matjes ndodhin për shkak të papërsosmërive në pyetësor, nën-raportimit, gabimeve të bëra nga intervistuesit gjatë mbledhjes së të dhënave, si dhe gjatë analizës së të dhënave.</p> <p>Hedhja e të dhënave të pyetësorëve të plotësuar është bërë në INSTAT duke përdorur Programin SQL me disa filtra kontrollesh të përcaktuara nga Eurostat.</p>
6.3.3. Gabimi në mos-përgjigje	<p>Gabimet e mos përgjigjes janë gabime për shkak të një përpjekje jo të suksesshme për të marrë informacionin e dëshiruar nga një njësi e pranueshme.</p> <p>Janë konsideruar dy lloje kryesore të gabimeve të mospërgjigjes:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Mos-përgjigja në nivel njësie: i referohet mungesës së informacionit nga e gjithë njësia (familjet dhe / ose personat) e zgjedhur në kampion; • Mos përgjigja në nivel variabli: i referohet situatës kur një njësi model është numëruar me sukses, por jo të gjitha informacionet e kërkuara janë marrë.
6.3.3.1. Shkalla e mos-përgjigjes së njësive	<p>84,1% e ndërmarrjeve në kampion plotësuan pyetësorin e AKP.</p> <p>14,4% e ndërmarrjeve të përzgjedhura nuk morën pjesë në anketën e kostos së punës sepse ishin të mbyllura, të fjetura ose refuzuan të përgjigjen.</p>
6.3.3.2. Mos-përgjigja në nivel variabli	<p>Mos përgjigja në nivel variabli: i referohet situatës kur një njësi vrojtimi është numëruar me sukses, por jo të gjitha informacionet e kërkuara janë marrë.</p> <p>Në rastin e AKP nuk ndodh që të ketë mos-përgjigje në nivel variabli, pasi nëse njësi përgjigjet atëhere informacioni jepet i plotë.</p>
6.3.4. Gabimi në procesim	<p>Në disa raste, vlerat e kostove janë në lekë, dhe në raste të tjera në mijëra lekë (monedhë kombëtare).</p> <p>Në disa raste është ngatërruar koncepti i orët totale të punës ("orët totale të punuara nga një punonjës gjatë gjithë vitit" me "orët totale të punuara nga të gjithë punonjësit gjatë një muaji").</p> <p>Në rastet e refuzimeve, janë bërë imputime.</p>
6.3.4.1. Shkalla e Imputimit	<p>Shkalla e imputimit në Anketën e Kostos së Punës është 10.1%.</p>
6.3.5. Shkalla e gabimit në modelin e parashikuar për vlerësim	<p>Nuk aplikohet.</p>

6.4. Rregullimi stinor	Nuk aplikohet.						
6.5. Politika e rishikimit	<p>Politikat e Rishikimit të Anketës të Kostos së Punës bëhen në përputhje me politikën e përgjithshme të rishikimit si dhe politikën e trajtimit të gabimeve të prezantura nga INSTAT si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Politika e revizionimit • Politika e trajtimit të gabimeve 						
6.6. Praktika e rishikimit	<p>Të dhënat e vrojtimit të AKP rishikohen kur:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Zbatohet një klasifikim i ri (psh. i aktiviteteve ekonomike); • Ekzistojnë ndryshime metodologjike; • Rishikimi i peshave (burime të reja dhe / ose të përmirësuara të të dhënave, korrigjime të gabimeve) 						
6.6.1. Rishikimi i të dhënave - madhësia mesatare	INSTAT nuk ka kryer rishikim të të dhënave të AKP 2020.						
7. Afatet kohore dhe përpikmëria							
7.1. Afatet kohore	<p>Numri i ditëve nga dita e fundit e periudhës referuese deri në ditën e botimit (kombëtar) të rezultateve të AKP.</p> <p>Rezultatet për AKP janë publikuar në faqen e internetit të INSTAT 631 ditë pas përfundimit të periudhës referuese (T + 631 ditë). Periudha referuese e rezultateve të AKP është 31 Dhjetori 2020.</p> <table border="1"> <tr> <td>Periudha referuese</td> <td>12/31/2020</td> </tr> <tr> <td>Data e publikimit</td> <td>9/23/2022</td> </tr> <tr> <td>Afatet kohore</td> <td>631</td> </tr> </table>	Periudha referuese	12/31/2020	Data e publikimit	9/23/2022	Afatet kohore	631
Periudha referuese	12/31/2020						
Data e publikimit	9/23/2022						
Afatet kohore	631						
7.1.1. Publikimi i rezultateve fillestare	Të dhënat e AKP nuk përfshijnë publikimin e rezultateve paraprake.						
7.1.2. Publikimi i rezultateve finale	Të dhënat e AKP 2020 janë publikuar 1 vit + 266 ditë pas përfundimit të periudhës së referencës. Periudha referuese e rezultateve të AKP 2020 është 31 Dhjetor 2020.						
7.2. Përpikmëria	<p>Vonesa kohore ndërmjet shpërndarjes aktuale të të dhënave dhe datës së synuar kur ato duhet të ishin dorëzuar.</p> <p>Të dhënat për AKP, publikohen bazuar në kalendarin e publikimeve. Publikimi i të dhënave mbi AKP, ka qenë i përpiktë në kohë në masën 100% të publikime të kryera.</p> <table border="1"> <tr> <td>Periudha referuese</td> <td>12/31/2020</td> </tr> <tr> <td>Data e shpallur</td> <td>9/23/2022</td> </tr> <tr> <td>Data e publikimit</td> <td>9/23/2022</td> </tr> </table>	Periudha referuese	12/31/2020	Data e shpallur	9/23/2022	Data e publikimit	9/23/2022
Periudha referuese	12/31/2020						
Data e shpallur	9/23/2022						
Data e publikimit	9/23/2022						

	Vonesa në kohë	0
7.2.1. Përpikmëria - shpërndarja dhe publikimi	<p>Rezultatet e botimit të AKP publikohen bazuar në kalendarin e publikimeve, i cili publikohet në faqen e internetit të INSTAT çdo vit. Publikimi i AKP ka qenë i përpiktë këtë vit duke u realizuar në kohë dhe pa vonesa.</p> <p>$P_3=d_{act}-d_{sch}= 9/23/2022 - 9/23/2022$ $P_3=0$</p>	
8. Koherenca dhe krahasueshmëria		
8.1. Krahasueshmëria gjeografike	Të dhënat janë plotësisht të krahasueshme. Përveç kësaj, nuk ka dallime të koncepteve kombëtare nga konceptet evropiane.	
8.1.1. Asymmetry for mirror flow statistics - coefficient	Nuk plotësohet nga INSTAT, llogaritet nga EUROSTAT pasi publikohen metadata.	
8.2. Krahasueshmëria kohore	<p>Të dhënat e AKP janë mbledhur në mënyrë të qëndrueshme që nga viti 2012. Në funksion të kësaj, të dhënat mund të konsiderohen të krahasueshme ose të pajtueshme me kalimin e kohës.</p> <p>Për AKP 2020 ashtu si AKP 2016 kampionimi është kryer në fillim të vitit pasardhës të vitit të referencës dhe është bërë në të gjitha seksionet e NVE Rev.2 përjashtuar seksionin O. Kampionimi i kryer afër periudhës së referencës minimizon mbulimin e tepert.</p> <p>Metoda e grumbullimit ishte e njëjtë me AKP 2016. Të anketuarit kishin mundësinë të përdorin një pyetësor të printuar dhe një pyetësor në internet. Të anketuarve iu dha një adresë interneti të Instat. Ata dërgojnë të dhënat e tyre duke zbatuar disa kontrolle. Në Institutin e Statistikave, 3.6 % e pyetësorëve janë mbledhur me e-mail për AKP 2016 dhe 2.9% për AKP 2020.</p> <p>Krahasuar me AKP 2016, në AKP 2020 pjesa e Pagave që ka pjesën më të madhe në Strukturën e Kostos së Punës, rritet për shkak të rritjes së pagave.</p> <p>Në AKP 2020, krahasuar me AKP 2016, për shkak të periudhës së pandemisë, përmes vendimeve të marra nga qeveria shqiptare për parandalimin e përhapjes së Covid-19 dhe dhënien e ndihmës ekonomike për bizneset, u ulën shpenzimet për trajnim profesional, taksa të punës dhe shpenzime të tjera, si dhe u rritën subvencionet e marra nga ndërmarrjet.</p> <p>Krahasuar me AKP 2016, në AKP 2020, për aktivitetet e Ndërtimit dhe Aktiviteteve profesionale, Shkencore dhe teknike, rritja e kostove të punës është më e madhe se në sektorët e tjerë për shkak të shpenzimeve më të mëdha për paga, sigurime shoqërore dhe shpenzimet e tjera të paguara nga punëdhënësi.</p>	

8.2.1. Gjatësia e serive kohore të krahasueshme	Të dhënat e AKP mund të konsiderohen të krahasueshme ose të pajtueshme me kalimin e kohës. Seritë kohore të krahasueshme ekzistojnë nga 2012, 2016 dhe 2020. $CC2 = Jfundit - Jfillimit + 1 = 3$ vjet.
8.3. Koherenca e ndërthurjes së fushave	Shiko tabelat në Aneks.
8.4. Koherenca e të dhënave me frekuenca të ndryshme mbledhjeje	Nuk aplikohet.
8.5. Koherenca - Llogaritë Kombëtare	Koherenca me Llogaritë Kombëtare nuk është llogaritur sepse "Kompensimi i punonjësve" llogaritet vetëm për ndërmarrjet e sektorit publik. Informacioni i marrë nga bilancet e ndërmarrjeve të sektorit privat nuk përmban indikatorin e pagave në natyrë.
8.6. Koherenca e brendshme	Konsistenca e brendshme e të dhënave të AKP kontrollohet para se të finalizohet. Kontrollohen lidhjet mes variablave dhe konfirmohet koherenca midis serive të ndryshme të të dhënave. Kështu të dhënat e vitit 2020 janë të krahasueshme dhe konsistente me vitet 2012 dhe 2016.
9. Aksesimi në të dhëna dhe qartësia	
9.1. Njoftim për media	Njoftimi për shtyp përmban informacion në lidhje me treguesit kryesorë të kostos së punës në Shqipëri. Format i njoftimit për shtyp ka ndryshuar. Ai përcaktohet nga sektori i botimeve, i cili përcakton edhe datën e botimit. Njoftimi për shtyp i AKP publikohet në internet në faqen zyrtare të INSTAT.
9.2. Publikime	Përdoruesit mund të gjejnë rezultatet e AKP 2020 të botuara në faqen e internetit të INSTAT: <ul style="list-style-type: none"> • Kosto e Punës
9.3. Baza e të dhënave on-line	Të gjitha informacionet vihen në dispozicion në dy gjuhë: Shqip dhe Anglisht. Të dhënat e Anketës së Kostos së Punës gjenden në: Databazën Statistikore .
9.3.1. Tabelat me të dhëna - Konsultimet	Klikimet (Page Views) në lidhje me të dhënat e "Anketës së Kostos së Punës" për vitin 2021 janë rreth 2.024 klikime.
9.4. Aksesimi në të dhënat mikro	Të dhënat e AKP nuk bëhen të disponueshme në nivel mikro, si pasojë e ruajtjes së konfidencialitetit. Të dhënat e agreguara, janë lloji i vetëm i të dhënave që ofrohet për përdoruesit e jashtëm. Edhe pse të dhënat mikro nuk publikohen, ato mund të aksesohen

	në bazë të nenit 31, pika 5 e ligjit nr 17/2018,"Për statistikat zyrtare".
9.5. Të tjera	Përdoruesit mund të dërgojnë kërkesa të tjera specifike nëpërmjet një seksioni të dedikuar për kontakte në linkun: Kontakt
9.6. Dokumentimi i metodologjisë	Një shpjegim i shkurtër lidhur me përkufizimet, konceptet kryesore dhe shpjegimet metodologjike për përdoruesit publikohet në njoftimin për shtyp dhe publikimet. Informacione shtesë u jepen përdoruesve të brendshëm kur është e nevojshme. Në faqen e INSTAT ka një seksion lidhur me Metodogjinë mbi Anketën e Kostos së Punës.
9.7. Dokumentimi i cilësisë	Sektori i Statistikave të Tregut të Punës dhe Pagave dokumenton gjithë procesin dhe procedurat e punës për AKP për qëllime të brendshme.
9.7.1. Shkalla e plotësisë së metadata-ve	Nuk plotësohet nga INSTAT, llogaritet nga EUROSTAT.
9.7.2. Metadata - Konsultimet	Nuk plotësohet nga INSTAT, llogaritet nga EUROSTAT pasi të jetë publikuar metadata.
10. Kostoja dhe ngarkesa	<p>Personat që punojnë për AKP janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Staf i në Zyrën Qendrore: 2 punonjës + 4 operatorë • Staf i në Zyrat Rajonale: 70 Intervistues, 4 Kontrollorë
11. Konfidencialiteti	
11.1. Konfidencialiteti - politika	Të dhënat e mbledhura nga INSTAT konsiderohen rreptësisht konfidenciale dhe përdoren vetëm për qëllime statistikore dhe kërkime shkencore në përputhje me Ligjin Nr.17/2018 "Për Statistikat Zyrtare" , si dhe Ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Mbrojtja e të Dhënave Personale" . Neni 31 i Ligjit për Statistikat Zyrtare, përcakton qartë se i gjithë informacioni statistikor i mbledhur nga INSTAT është konfidencial dhe mund të përdoret ose publikohet vetëm në tabela përmbledhëse, për të mos identifikuar njësinë burimore të informacionit.
11.2. Konfidencialiteti - trajtimi i të dhënave	INSTAT mbron dhe nuk shpërndan të dhënat që ka mbledhur ose që ka akses, të cilat mundësojnë identifikimin e drejtpërdrejtë ose të tërthortë të njësive statistikore. INSTAT ndërmerr të gjitha masat e duhura për të parandaluar dhe bërë të pamundur identifikimin e njësive statistikore përmes mjeteve teknike të tjera që mund të përdoren nga palët e treta. Të dhënat statistikore që mund të bëjnë të mundur identifikimin e njësive statistikore,

shpërndahen nga INSTAT vetëm në rast se:

- a) Këto të dhëna janë trajtuar, siç është përcaktuar në mënyrë të veçantë në Rregullore, këto të dhëna janë trajtuar në mënyrë të atillë, sa nuk krijon paragjykim në lidhje me konfidencialitetin statistikor; ose
- b) Njësia statistikore ka dhënë miratimin përkatës për bërjen publike të të dhënave;

Të dhënat konfidenciale i përcillen INSTAT-it vetëm për qëllime statistikore dhe vetëm personat që kanë të drejtë akses, mund të punojnë me to. Çështjet dhe problemet në lidhje me ruajtjen e konfidencialitetit statistikor verifikohen dhe trajtohen nga stafi i INSTAT. Përgjegjësitë e këtij stafi, janë të përcaktojë shkallën e detajeve që mund të shpërndahet dhe të bëhet publike nga INSTAT. Përgjegjësitë e këtij stafi janë të rekomandojë dhe përcaktojë: në çfarë nivel detajimi mund të publikohen dhe shpërndahen këto të dhëna, në mënyrë që identifikimi i drejtpërdrejtë ose i tërthortë i njësisë statistikore të vrojtuar të mos jetë i mundur; kriteret e anonimizimit për mikrodatat që u janë dhënë përdoruesve; dhënia e hyrjes për hulumtuesit në të dhëna konfidenciale për qëllime shkencore.

12. Komente

Aneks

Tab 1: Shpërndarja e ndërmarrjeve që plotësuan anketën sipas seksioneve të NVE Rev2 dhe madhësisë së ndërmarrjes(zgjedhja efektive), AKP 2020

Seksioni NVE Rev 2	Aktiviteti ekonomik	10-49 të punësuar 10-49 employees	50-249 të punësuar 50-249 employees	250-499 të punësuar 250-499 employees	500-999 të punësuar 500-999 employees	1000 të punësuar e më shumë 1000 or more employees	10 të punësuar e më shumë 10 or more employees	Përqindja sipas seksioneve NVE Rev2 Marginal Distribution by NACE sections %
B	Industri nxjerrëse	66	25	1	0	2	94	2,9
C	Industri përpunuese Furnizimi me Energji Elektrike, Gaz e Avull dhe	366	382	42	7	5	802	24,6
D	me Ajër të Kondicionuar Aktivitetet me ujë të ngruhtë, kanalizimeve, menaxhimit të mbeturinave dhe rregullimit	15	8	1	3	1	28	0,9
E	Ndërtimi	27	59	7	2	1	96	2,9
F	Tregtia me shumicë dhe pakicë; Riparimi i automobilave e motoçikletave	80	189	18	5	0	292	9,0
G	Transport dhe magazinim	217	202	17	3	0	439	13,5
H	Akomodimi dhe aktivitetet e shërbimit të ushqimit	52	32	2	1	1	88	2,7
I	Informacioni dhe Komunikacioni	188	46	1	0	0	235	7,2
J		86	44	5	2	0	137	4,2

K	Aktivitetet financiare dhe Sigurimit	40	15	10	5	1	71	2,2
L	Pasuritë e patundshme	28	7	1	0	0	36	1,1
M	Aktivitetet profesionale, Shkencore dhe teknike	92	47	1	2	1	143	4,4
N	Aktivitetet administrative dhe Shërbimet mbështetëse	71	128	20	7	3	229	7,0
P	Arsimi	30	87	36	19	8	180	5,5
Q	Shëndetësia dhe veprimtari të tjera sociale	74	83	13	8	2	180	5,5
R	Art, Argëtim dhe zbavitje	58	15	2	0	0	75	2,3
S	Aktivitete të tjera shërbimi	103	25	3	0	0	131	4,0
B-S	Gjithsej	1.593	1.394	180	64	25	3.256	100,0
Përqindja sipas madhësisë së ndërmarrjes								
Marginal Distribution by size-class (%)								
		48,9	42,8	5,5	2,0	0,8	100,0	

Tab 2: Koefficientët e variacionit për koston totale vjetore të punës sipas seksioneve të NVE Rev2, AKP 2020

Seksioni	Aktiviteti ekonomik	Kosto Totale vjetore e punës (në lekë)	Devijimi Standard Standard deviation	Koefficienti i variacionit (%) Coefficient of variation (%)
B-S	Gjithsej	311.234.709.866	2.389.090.658	0,77
B	Industria nxjerrëse	9.836.927.152	90.414.912	0,92
C	Industria përpunuese	48.004.935.160	449.193.320	0,94
D	Energjia elektrike, gazi, Avulli dhe Furnizimi me ajër të kondicionuar Furnizimi me ujë, Aktivitetet e trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetjeve	10.152.495.412	26.150.050	0,26
E	Ndërtimi	6.684.280.620	56.377.064	0,84
F	Tregtia me shumicë dhe me pakicë, Riparimi i automjeteve dhe motoçikletave	33.831.717.829	240.694.181	0,71
G	Transporti dhe magazinimi	40.668.553.224	301.048.344	0,74
H	Akomodimi dhe shërbimi ushqimor	7.919.691.488	65.223.091	0,82
I	Informacioni dhe Komunikacion	6.851.869.290	92.607.380	1,35
J	Aktivitetet financiare dhe Sigurimit	14.002.871.700	154.014.200	1,10
K	Pasuritë e patundshme	18.326.525.289	107.831.922	0,59
L	Aktivitete profesionale, Shkencore dhe Teknike	1.154.480.768	21.782.656	1,89
M	Shërbime administrative dhe mbështetëse	10.560.033.510	133.351.959	1,26
N	Arsimi	25.303.919.550	152.821.851	0,60
P	Shëndetësia	41.447.949.045	152.823.393	0,37
Q	Arte, Argëtim dhe Çlodhje	27.810.708.875	148.758.025	0,53
R	Aktivitete të tjera shërbimi	2.946.837.300	57.338.780	1,95
S	Aktivitete të tjera shërbimi	5.647.642.749	92.256.146	1,63

Tab 3: Koefficientët e variacionit për koston e punës për orë sipas seksioneve të NVE Rev2, AKP 2020

Seksioni		Kosto mesatare orare e punës (në lekë) Annual total labour cost (in Albanian LEK)	Devijimi Standard Standard deviation	Koeficienti i variacionit (%) Coefficient of variation (%)
B-S	Gjithsej	391	1,2	0,32
B	Industria nxjerrëse	503	4,1	0,81
C	Industria përpunuese	272	2,1	0,74
D	Energjia elektrike, gazi, Avulli dhe Furnizimi me ajër të kondicionuar	490	10,2	2,07
E	Furnizimi me ujë, Aktivitetet e trajtimit dhe menaxhimit të mbeturinave, mbetjeve	281	1,1	0,39
F	Ndërtimi	417	6,6	1,59
G	Tregtia me shumicë dhe me pakicë, Riparimi i automjeteve dhe motoçikletave	343	3,1	0,90
H	Transporti dhe magazinimi	417	6,9	1,67
I	Akomodimi dhe shërbimi ushqimor	245	4,8	1,96
J	Informacioni dhe Komunikacion	566	4,6	0,82
K	Aktivitetet financiare dhe Sigurimit	756	1,1	0,14
L	Pasuritë e patundshme	356	5,6	1,57
M	Aktivitete profesionale, Shkencore dhe Teknike	566	4,0	0,71
N	Shërbime administrative dhe mbështetëse	359	4,6	1,28
P	Arsimi	491	2,0	0,42
Q	Shëndetësia	408	2,8	0,68
R	Arte, Argëtim dhe Çlodhje	442	3,6	0,81
S	Aktivitete të tjera shërbimi	409	4,0	0,98

Tab 4: Koeficientët e variacionit për koston totale vjetore të punës sipas madhësisë së ndërmarrjes, AKP 2020

Madhësia e ndërmarrjes	Kosto Totale vjetore e punës (në lekë)	Devijimi Standard	Koeficienti i variacionit (%)
	\hat{t}	$\sqrt{V(\hat{t})}$	$CV(\hat{t})$
B-S	311.234.709.866	2.389.090.658	0,77
10-49	94.921.871.122	1.622.916.027	1,71
50-249	97.351.570.233	1.520.503.119	1,56
250-499	50.314.318.776	365.259.352	0,73
500-999	35.352.100.890	141.203.632	0,40
1000+	33.271.585.500	0	0,00

Tab 5: Koeficientët e variacionit për koston e punës për orë sipas madhësisë së ndërmarrjes, AKP 2020

Madhësia e ndërmarrjes	Kosto e punës për orë (në lekë)	Devijimi Standard	Koeficienti i variacionit (%)
	\hat{t}	$\sqrt{V(\hat{t})}$	$CV(\hat{t})$
B-S	391	1,2	0,32

10-49	360	3,1	0,86
50-249	365	2,5	0,68
250-499	418	1,1	0,27
500-999	454	1,3	0,30
1000+	490	-	0,00

Tab 6: Përqindja e korrigjimit dhe imputimit

Variabli	Përshkrimi i Variablit	Përqindja e korrigjimit dhe imputimit, AKP 2016	Përqindja e korrigjimit dhe imputimit, AKP 2020
A1	Numri i të Punësuarve me pagë	13,1	13,9
A11	Numri i të Punësuarve me pagë me kohë të plotë	13,1	13,9
A12	Numri i të Punësuarve me pagë me kohë të pjesëshme	0	0
B11	Orët reale të punura nga të punësuarit me pagë me kohë të plotë	13,1	13,9
B12	Orët reale të punura nga të punësuarit me pagë me kohë të pjesëshme	0	0
C11	Orët mesatare të paguara për të punësuarit me pagë me kohë të plotë	9,2	8,9
C12	Orët mesatare të paguara për të punësuarit me pagë me kohë të pjesëshme	0	0
D11111	Pagesa dhe shpërblime direkte të paguara në çdo periudhë pagese	13,1	13,9
D11112	Pagesa dhe shpërblime direkte jo të paguara në çdo periudhë pagese	2,2	1,9
D1114	Pagesa në natyrë	1,1	1,5
D1211	Kontributet e sigurimeve shoqërore të detyrueshme	13,1	13,9
D1212	Kontribute të tjera vullnetare të sigurimeve shoqërore	6,4	6,9
D1223	Pagesa për punonjësit që largohen nga ndërmarrja	0	0
D2	Kostot e Trajnimit profesional	7,3	6,5
D3	Shpenzime të tjera të paguara nga Punëdhënësi	11,8	11,5
D4	Taksat e Punës	0,4	0,2
D5	Subvencionet e marra nga punëdhënësi	0,6	0,9

Tab 7. Paga vjetore bruto për një të punësuar me pagë

Seksioni NVE Rev. 2 / NACE Rev. 2 Section	ASN 2020	AKP 2020
B-S	596	828
B	1.048	1.076
C	513	612
D	972	1.046
E	543	600
F	518	915
G	564	751
H	707	893
I	391	538
J	928	1.242
K	-	1.634
L	652	778
M	956	1.201
N	572	768
P	645	863
Q	650	880
R	-	940
S	677	870

Tab 8. Orët aktuale të punuara nga një punënjës me pagë në punën kryesore

Seksioni I NVE Rev.2	Aktiviteti Ekonomik	AFP2020	AKP2020
B	Industria nxjerrëse	2.384	2.140
C	Industria përpunuese	2.227	2.180
D	Furnizimi me Energji Elektrike, Gaz e Avull dhe me Ajër të Kondicionuar	2.173	2.135
E	Aktivitetet me ujë të ngrohtë, kanalizimeve, menaxhimit të mbeturinave dhe rregullimit	2.178	2.138
F	Ndërtimi	2.165	2.193
G	Tregtia me shumicë dhe pakicë. Riparimi i automobilave e motorçikletave	2.315	2.186
H	Transport dhe Magazinim	2.114	2.166

I	Akomodimi dhe aktivitetet e shërbimit të ushqimit	2.135	2.197
J	Informacioni dhe Komunikacioni	1.824	2.193
K	Aktivitetet Financiare dhe Sigurimit	1.983	2.160
L	Pasuritë e patundëshme	2.534	2.188
M	Aktivitetet Profesionale, Shkencore dhe teknike	2.010	2.121
N	Aktivitetet Administrative dhe Shërbimet mbështetëse	2.169	2.140
P	Arsimi	1.574	1.759
Q	Shëndetësia dhe veprimtari të tjera sociale	2.099	2.159
R	Art, Argëtim dhe zbavitje	1.726	2.126
S	Aktivitete të tjera shërbimi	1.722	2.128